

VENDIM
Nr. 79, datë 28.1.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIMI I AMFITEATRIT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rehabilitimi i Amfiteatrit të Durrësit”, miratuar me vendimin nr. 112/2014, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi për pasurinë truall dhe ndërtim, me një vlerë të përgjithshme ndërtimi prej 21 660 027 (njëzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëzet e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 21 660 027 (njëzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëzet e shtatë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Kulturës.

5. Shpronësimi të fillojë në datën 31.1.2015.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Kulturës.

7. Shpenzimet për botimet publike në gazeta të përballohen nga fondet e aparatit të Ministrisë së Kulturës, zëri “602”.

8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “sipas kartelës së pasurisë”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe (m ²)		Çmimi Lekë/m2		Vlera lekë			SHËNIME
				truall	ndërtim	truall	ndërtim	truallit	ndërtese	banesë	
1	Ahmet Dragovoja	8512	24/15	156.0	236.5	17,898	70,093	2,792,088		16,576,994.50	sipas kartelës së pasurisë
3	Jonuz Myshketa	8512	24/173	128.0	0.0	17,898	70,093	2,290,944		-	sipas kartelës së pasurisë
				284	236.5			5,083,032		16,576,995	21,660,027
	TOTALI:					21,660,027 LEKË					